

## INFORMACION MBI RIATDHESIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË

Pas mbylljes së kufijve dhe kufizimit të lëvizjes si rrjedhim i masave të marra për parandalimin e pandemisë së COVID-19, Qeveria Shqiptare nisi një operacion për riatdhesimin e qytetarëve shqiptarë të mbetur jashtë kufijve.

**Faza e parë e riatdhesimeve** nisi në 28 mars 2020 dhe gjatë saj u riatdhesuan studentët dhe personat më në vështirësi që u gjendën jashtë vendit në momentin e mbylljes së kufijve. Gjatë kësaj faze u riatdhesuar **rreth 1000 persona**, sipas listave të hartuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

**Faza e Dytë** e Operacionit Riatdhesimi, vijon prej datës 18 Prill 2020, me fluturime nga **7 shtete**

Fluturimet kanë shërbyer për Riatdhesimin e qytetarëve shqiptarë që janë larguar për periudha të shkurtra (*turizëm, studime, shëndetësi, biznes*) dhe që mbetën të bllokuar në vende të ndryshme të BE, Turqi por jo vetëm.

Gjatë kësaj faze është **realizuar edhe rikthimi i qytetarëve nga Kontinente të tjerë**, përmes bashkëpunimit me Ambasadat Shqiptare, dhe përpjekjeve për **kombinimin e fluturimeve nga vendet e origjinës së tyre** me fluturimet e Air Albania.

- SHBA, Kanada, Brazil, Arabi Saudite, Egjipt, Tajlandë,

Përmes koordinimit me përfaqësinë diplomatike të Kosovës, **janë realizuar kthime të kadetëve të FSK nga Turqia, studentë e qytetarë** nga vende të BE.

- Deri në datën **09.05.2020** janë riatdhesuar përmes **29 fluturimeve** në Shqipëri në Total **3.618 qytetarë** nga **9 vende** origjine. (*Stamboll, Romë, Milano, Bari, Frankfurt, Londër, Paris, Madrid, Zyrih*)

**NË TOTAL janë riatdhesuar rreth 4600 persona që prej nisjes së procesit e deri në datë 09 maj 2020**